

LINDITA ÇIFÇIU

**SINONIMIA FRAZELOGJIKE NË FJALORËT DYGJUHËSH
ITALISHT SHQIP DHE SHQIP ITALISHT**

Sinonimia është një relacion leksikor shumë i njohur. Prof. J. Thomai pranon se *“sinonimet janë fjalë të ndryshme me kuptim të njëjtë a të afërt, duke pasur dytre a më shumë fjalë që shënojnë të njëjtin send, të njëjtin tipar, të njëjtin veprim apo të njëjtën dukuri”*¹. Dhe ai vazhdon më tej se *“Sinonimet përdoren si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar. Sa më shumë sinonime të ketë gjuha standarde, aq më i pasur është leksiku i saj. Me anë të tyre gjuha shpreh nuancat më të holla të mendimit, bëhet më e bukur dhe më e zhdërvjellët. Gjuha standarde shqipe është e pasur me sinonime dhe kjo u jep forcë ligjërimi, i bën të gjalla e të larmishme.”*²

Për sinonimet janë bërë studime të shumta. Prof. Shefkije Islamaj, Kosovë, ka hartuar dhe monografinë *“Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe”*, ku e ka trajtuar gjerësisht këtë relacion. Ajo thekson se *“sinonime konsiderohen fjalët të cilat kanë një domethënie të njëjtë leksikore dhe dallohen vetëm nga nuancat kuptimore, nga ngjyrat ekspresive dhe nga përkatësia e njërës apo e tjetrës sferë stilistikore, që kanë deri diku një përputhshmëri të plotë a të pjesshme, kështu që në kontekste të caktuara janë të zëvendësueshme në mes vete”*³.

Sinonimet e një gjuhe mund të jenë sinonime fjalë dhe sinonime frazeologji. Gjuha jonë është shumë e pasur me njësi të tilla dhe vazhdon të pasurohet pa ndërprerje, sepse dhe vetë procesi i njohjes për sende, fenomene, dukuri, tipare etj. vjen duke u thelluar dhe duke u zgjeruar, duke shtuar edhe numrin e njësive emërtuese për to dhe që na çon krejt natyrshëm te shtimi i numrit të sinonimeve.

Si pjesë e rëndësishme e leksikut, sinonimet zënë vend dhe në fjalorët e ndryshëm, qofshin njëgjuhësh (fjalorë shpjegues), qofshin dy e shumëgjuhësh.

Prof. J. Thomai thekson se:

“a) Sinonimet janë mjete të fuqishme, sidomos në letërsinë artistike, për ta bërë ligjërimin sa më të gjallë, për të saktësuar më tej mendimin, për të tipizuar më mirë vetat, rrethanat dhe mjediset.

b) Sinonimet përdoren si ndër mjetet më të mira për pasurimin e fjalorit të nxënësve gjatë punës me gjuhën në shkollë.

c) Gjatë hartimit të fjalorëve sinonimet e gjuhës standarde përdoren si mjete shpjegimi për fjalët krahinore, të vjetruara a të huazuara, për variantet fjalëformuese ose si mjete plotësuese në shpjegimet me perifrazim; p.sh. *bajloz-i*

¹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 153.

² J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 170.

³ Sh. Islamaj, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1985, f. 51.

*m. vjet. ambasador; dhaskal-i m. keq. mësues; misk/ë-a f. krahin. pulëdeti; linguistik/ë-a f. libr. gjuhësi etj.*⁴

Në këtë punim të shkurtër ne po ndalemi te sinonimia frazeologjike tek fjalorët dygjuhësh italisht- shqip dhe shqip-italisht. Gjuha shqipe ka rreth 500 fjalorë dhe një leksikografi me histori rreth 400-vjeçare. Leksikografia italisht – shqip dhe shqip – italisht është me vjetra në leksikografinë e shqipes, sepse më të fillon dhe vetë kjo leksikografi, si dhe më e pasura me vepra.

Profesor J. Thomai thekson se “Ndër fjalorët e shqipes me italishten, më të shumtë në leksikografinë dygjuhëshe shqipe, po shënojmë: “*Fjalor italisht-shqip*” (2002, me rreth 40000 fjalë) dhe “*Fjalor shqip-italisht*” (2003, me rreth 40000 fjalë), të hartuar nga Ferdinand Leka e Zef Simoni; po shtojmë edhe disa tituj fjalorësh të shqipes me italishten: “*Fjalor shqip-italisht*” (*Vocabolario albanese-italiano*, 1979, me rreth 25000 fjalë), i hartuar nga C. B. Mussolini, U. Buttafava; “*Fjalor italisht-shqip*” (1997, me rreth 40000 fjalë) dhe “*Fjalor shqip-italisht*” (1999, me rreth 40000 fjalë), të hartuar nga Abedin Preza.”⁵

Megjithatë ky pohim i prof. J. Thomait nuk është i plotë sepse fjalorë shqip – italisht dhe italisht – shqip janë botuar disa të tjerë dhe me vëllim deri në 75.000 fjalë si ata të botuar nga Abedin Preza dhe Ervin Preza.

Fjalorët dygjuhësh përgjithësisht mund të perceptohen si fjalorë sinonimikë, por duke e parë sinoniminë jo si sinonimi të brendshme, brenda një gjuhe, por si sinonimi të jashtme, ndërmjet dy gjuhëve. Nga vetë natyra pragmatike e fjalorëve dygjuhësh, për të sjellë fjalën në një gjuhë dhe barasvlerësin e tij sa më të gjetur në gjuhën tjetër, krejt normalisht, mënjanohet edhe përdorimi i sinonimisë brenda një zëri leksikografik.

Ne jemi ndalur në dy vepra për të parë më konkretisht këtë dukuri. Nga *Fjalor italisht-shqip* i hartuar nga F. Leka, Z. Simoni, dy nga leksikografët më të mirë në këtë leksikografi, kemi marrë fjalën syri. Siç shihet më poshtë, sinonimia në frazeologjinë gati nuk ekziston.

sy, –ri m. sh. –, –të 1) (anat.) occhio – **sy të zinj** occhi neri – **sy xhami** occhio di ventre – **i verbër me një sy** cieco di un occhio – **me sy të mbyllur** a occhi chiusi – **me sy të zhveshur (të lirë)** a occhio nudo – **mbyll sytë** (edhe *fig.*) chiudere gli occhi – **s’kam mbyllur sy gjithë natën** non ho chiuso occhio tutta la notte – **i nxjerr sytë diku**jt cavare gli occhi a qu. – **shqyej sytë** sbarrare gli occhi – **shkel syrin** strizzare l’occhio; 2) occhio; sguardo – **një sy** un colpo d’occhio – **me sy** a occhio – **me sytë për dhë** con gli occhi a terra – **sa të rrok syri** a perdita d’occhio – **rritet ndër sy** cresce a vista d’occhio – **ul sytë** abbassare gli occhi – **ngre sytë** alzare gli occhi – **mat me sy** calcolare a occhio – **bie në sy** dare nell’occhio; farsi notare – **jam tërë sy e veshë** essere tutt’occhi e tutt’orecchi – **perëndoj sytë** fare gli occhi dolci – **ngul sytë** fissare gli occhi – **i hedh një sy diçkaje** gettar l’occhio a qc. – **nuk ia ndaj sytë diku**jt non levare gli occhi di dosso a qu. – **shikoj dikë drejt e në sy** piantare gli occhi in faccia a qu.; 3) occhio; attenzione – **hap sytë mirë në kthesa!** occhi alle curve! – **s’më shpëton gjë nga syri** aver l’occhio a tutto – **nuk i kishte sytë në ballë** non aveva gli occhi in capo; 4) sh. (*bised.*) viso, faccia – **sy më sy**

⁴ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 170-171.

⁵ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 354.

Sinonimia frazeologjike në fjalorët dygjuhësh italisht shqip...

faccia a faccia – **laj sytë** lavarsi la faccia; 5) laccio; nodo – **syri i litarit** il nodo della corda; 6) (tek.) occhio – **syri i pistonit** l'occhio del pistone – (shtypshkr.) **syri i shkronjës** l'occhio del carattere. ► **Sy i keq** malocchio – **e ka syrin e keq** è uno iettatore; ha la iettatura – **sy për sy** a quattr'occhi – **halë në sy** comme un prugno nell'occhio – **në sytë e botës** agli occhi del mondo – **sa çel e mbyll sytë** in un batter d'occhio – **sa për sy e faqe** tanto per salvare le apparenze – s'më bën syri tërr non batter occhio – **më bëjnë sytë** avere le traveggole – **bie në sy** dare nell'occhio – **i hedh hi syve** gettare la polvere negli occhi – **ka sy e faqe të flasë** ha la spudoratezza (il coraggio) di parlare – **kam syrin të...** ho l'intenzione di... – **i kanë plasur sytë** ha la benda agli occhi – **i kanë zënë sytë lesh** ha gli occhi foderati di prosciutto – **kullot sytë** pascere l'occhio; pascersi gli occhi – **(ia) mbush syrin** piacere; convincere – **s'ma mbush syrin** non m'i convince; non fa al caso mio – **mbyll një sy për diçka** chiudere un occhio su qc. – **shikoj me bisht të syrit** guardare con la coda dell'occhio – (fj. u.) **korbi korbit** (sorra sorrës) **s'ia nxjerr sytë** corvi con corvi non si cavano mai gli occhi – (fj. u.) **larg sysh, larg zemre** lontan occhi, lontan dal cuore.⁶

E njëjta gjendje shfaqet edhe kur shohim fjalorë italisht-shqip. Nga *Fjalori italisht-shqip* i hartuar po nga autorët e mësipërm, F. Leka, Z. Simoni, po japim përsëri zërin Sy.

occhio m. 1) (anat.) sy – **occhi neri** (azzurri) sy të zinj (të kaltër) – **occhio di ventro** sy xhami – **la coda dell'occhio** bishti i syrit – **guardare con la coda dell'occhio** shikoj me bisht të syrit – **cieco di un occhio** i verbër me një sy; pa një sy – **a occhio asciutto** pa nxjerrë pikë loti – **a occhi chiusi** me sy të mbyllur; symbyllazi – **a occhio nudo** me sy të zhveshur (pa mjet shikimi) – **a tutt'occhi** sy për sy, vetëm për vetëm – **comme il fumo negli occhi** si kripën në sy – **comme un pugno in un occhio** halë (plagë, ferrë) në sy – **con gli occhi in fuori** me sy të dalë përjashta; me sy të zgurdulluar – **in un batter d'occhio** sa çel e mbyll sytë, në çast – (fig.) **fino agli occhi** deri në grykë – (fig.) **nei debiti fino agli occhi** i zhytur në borxhe deri në grykë – (fig.) **infangato fino agli occhi** i bërë me llucë deri në fyt – **dove hai gli occhi?** ku i ke sytë? a i ke sytë në ballë? **chiudere gli occhi** a) mbyll sytë b) (fig.) mbyll (err) sytë përgjithmonë – (fig.) **chiudere un occhio su qc.** mbyll një sy (qorroj njërin sy) për diçka – **non ho chiuso (un) occhio tutta la notte** s'kam mbyllur sy (s'kam vënë gjumë në sy) tërë natën – **non batter occhio** s'më bën syri tërr – **cavare gli occhi a qu.** i nxjerr sytë dikujt, verboj dikë – **si caverebbero gli occhi** janë gati t'i nxjerrin sytë njëri-tjetrit – **dare (ose fare) d'occhio a qu.** ia bëj me sy (i shkel syrin) dikujt – **guardare sott'occhio** shikoj me bisht të syrit – **sbarrare (ose spalancare) gli occhi** zgurdulloj (shqyej) sytë – **strizzar l'occhio** shkel (luaj) syrin, bëj me sy – (fig.) **aprire gli occhi a qu.** i hap sytë dikujt – (fig.) **cavarsi gli occhi** nxjerr sytë, më dalin sytë (nga drita e dobët etj.) – (fig.) **guardare con tanto d'occhi** i hap sytë na – (fig. bised.) **ha gli occhi foderati di panno (ose di prosciutto)** i kanë zënë sytë lesh; është syplasur (sylesh); 2) sy, shikim – **un colpo d'occhio** shikim i shpejtë, një sy – **a occhio** me sy, me tahmin; me përafërsi – **con occhio distratto** si i hutuar; pa e pasur mendjen – **con gli occhi a terra** me sytë përdhe – **a perdita d'occhio** sa të rrok syri – **a vista d'occhio** me shpejtësi, ndër sy – **cresce a vista d'occhio (të)** rritet ndër sy (para syve) – **abassare gli occhi** ul sytë – **alzare gli occhi** ngre sytë, shikoj lart – **calcolare a occhio** mat me sy – **dare nell'occhio** bie në sy – **essere tutt'occhi e tutt'orecchi** i bëj sytë katër e veshët bigë, jam tërë sy e veshë – **fare l'occhio a...** stërvit syrin me... – **fare gli occhi dolci** perëndoj sytë (për dikë që dua) – **non fate quegli occhi!** mos më shikoni ashtu! – **fissare gli occhi** ngul sytë, mbërthej sytë (diku) – **gettare l'occhio a...** i hedh një sy... – **non levare gli occhi di dosso** nuk (ia) ndaj (nuk ia

⁶ F. Leka, Z. Simoni, *Fjalori italisht-shqip*, Tiranë, 2003, f. 667-668.

shqit) sytë – **mettere gli occhi addosso** (i) vë syrin, lakmoj me sy – **piantare gli occhi in faccia a qu.** ia ngul sytë dikujt; shikoj dikë drejt në sy – **salta agli occhi** e sheh edhe qorri – (fig.) **aguzzare gli occhi** i bëj sytë katër – (fig.) **buttare (ose gettare) la polvere negli occhi** hedh hi syve – (fig.) **pascere d'occhio** kullot sytë – (ff. u.) **lontan dagli occhi, lontan dal cuore** larg sysh, larg zemre; 3) (fig.) sy (shprehje e syve) – **occhi feroci** sy të egër – **occhi gioiosi** sy të gëzuar – **occhi ridenti** sy të qeshur; 4) (fig.) sy (aftësi për të kuptuar diçka) – **gli occhi della mente** sytë e mendjes – **agli occhi del mondo** në sytë e botës – (mjek.) **occhio clinico** sy klinik (mjeku) – **avere la benda agli occhi** më kanë plasur (më janë veshur) sytë (nga një pasion etj.) – **perdere il lume degli occhi** verbohem (nga inati etj.) – **vedere di buon occhio (di mal occhio) qu.** shoh me sy të mirë (me sy të keq) dikë; 5) (fig.) dritë e syrit (gjë e çmuar) – **è il suo occhio destro** e ka (e ruan) si dritën e syve (si syrin e vetëm) – **mi è caro come la luce degli occhi** e dua si dritën e syve – **costare un occhio della testa** kushton qimet e kokës (pikë e gjak); 6) (fig.) sy (kujdes, vëmendje) – **occhi alle curve!** hap sytë mirë në kthesa! – **aver l'occhio a tutto** s'më shpëton gjë (pa e parë) – **non aveva gli occhi in capo** nuk i kishte sytë në ballë; 7) (spec.) sy, vrimë – **l'occhio del martello** vrima e çekiqit (ku hyn bishti) – **gli occhi del framaggio** vrimat e djathit; 8) (shtypshkr.) sy (i shkronjës); 9) (bot.) syth, bulë – **innesto a occhio** shartim me syth – **occhio di pernice** lulemerimangë – **occhio di diavolo** sydjall; 10) (arkit.) **occhio di bue** dritare e rrumbullakët (ose vezake); 11) (miner.) **occhio di gatto (ose di tigre)** xhevahir kuarc; 12) (entom.) **occhio di pavone** sy palloi.⁷

Krejt ndryshe del sinonimia në fjalorët e mirëfilltë sinonimikë, qofshin këta edhe dygjuhësh. Ajo zë vend edhe në këta lloj fjalorësh duke ndjekur traditën dhe në përputhje me tipin e fjalorit, me aftësinë e profesionalizmin e autorit hartues, me nivelin e fjalorëve sinonimikë të hartuar, si dhe me vetë nivelin që ka arritur hartimi i veprave leksikografike në një gjuhë të dhënë.

Kështu, në vazhdim ne po ndalemi te *Fjalori i madh frazeologjike italisht – shqip*, me 20.000 shprehje frazeologjike, të hartuar nga Naim Balla, Esheref Ymeraj, Irena Ndoci (Lama). Ky është një nga fjalorët më të mirë dygjuhësh dhe i më i miri i hartuar deri tani për frazeologjinë dygjuhëshe në vendin tonë.

Po japim për ilustrim edhe këtu njësitë frazeologjike që lidhen me fjalën *Öcchio / sy*, por vetëm një pjesë të tyre, sepse grupi me njësi frazeologjike me sy është shumë i pasur, si në italisht dhe në shqipe, e për rrjedhojë edhe në këtë fjalor. Lënda që kemi zgjedhur e jep qartë sinoniminë frazeologjike sidomos të shqipes.

ÖCCHIO – 1. sy; 2. sy, shikim; 3. sy (shprehje e syve); 4. sy (aftësi për të kuptuar për diçka); 5. dritë e syrit; 6. sy (kujdes, vëmendje); 7. sy, vrimë; 8. sy (i shkronjës); 9. syth, bulë. **A colpo d'occhio** – “*me goditje të syrit*”; menjëherë; me shikimin e parë; me të parën; si mbresë e parë. **A occhi aperti** – “*me sy hapët*”; me ndërgjegje; me vetëdije; me dijeni të plotë. Edhe: me hesap (pasi e vlerëson një situatë dhe përcakton sjelljen, qëndrimin e përshtatshëm). Ka edhe kuptimin: me kujdes; me kujdes dhe pak besim. Në këtë rast rëndësi ka që të sigurohem për të njohur situatën kundruall në mënyrë që të përballohen të papriturat rastësore dhe të parandalohen, para së gjithash, surprizat e pakëndshme. **A occhi chiusi** – “*me sy mbyllur*”; symbyllazi; me siguri; me plot besim; pa kontrolluar; pa marrë masa paraprake. **A occhio** – “*me sy*”; me sy të zhveshur; me sy të lirë. Pa ndihmën e instrumenteve matëse, afërsisht; pak a shumë; me hesap të përafërt (shih edhe: *fare occhi e*

⁷ F. Leka, Z. Simoni, *Fjalori italisht-shqip*, Tiranë, 2000, f. 731-732.

Sinonimia frazeologjike në fjalorët dygjuhësh italisht shqip...

croce). **A occhio nudo** – “me sy të zhveshur”; me sy të pambrojtur nga mjete shikimi; pa përdorimin e instrumenteve optike (gjyzykëve etj.); pa dylbi. I referohet një sendi që shihet, lexohet ose, rrallë, matet. Më gjerë: përdoret për sende shumë të qarta, me përvijime dhe reliev të madh; për një ndryshim të dukshëm ose për një gabim, një mangësi etj., që shihet qartë. **A perdita d’occhio** – “derisa shkon shikimi”; sa të rrok (sa të ha) syri. Përdoret për të treguar një shtrirje shumë të gjerë, madje më përtej se ç’mund të arrijë shikimi. **A quattr’occhi** = **parlare a quattr’occhi** = **vedersi a quattr’occhi** – “(flas, shoh) me të katër sytë”; sy për sy (sy në sy); vetëm për vetëm (me dikë); një për një; kokë për kokë; privatisht; pa praninë e të tjerëve; pa të pranishëm të tjerë; midis miqsh. Bëhet një bisedë private midis dy njerëzve pa praninë e askurrkujt. Nënkupton një bisedë sekrete ose në mirëbesim. **A vista d’occhio** – “sa të zë (të kap) syri”; sa të sheh (të rrok, të ha) syri. Edhe: në sy, me shpejtësi të madhe. Thuhet për diçka që rritet, ndryshon, zhvillohet shpejt, në mënyrë të dukshme, që shihet qartë, sa mund të bjerë në sy pa pasur nevojë për matje; mu përpara syve; rrëmbimthi; vetëtimë. **Aguzzare gli occhi** = **aguzzare le ciglia** – “mpreh sytë”; hap sytë; i bëj sytë katër. Kërkoj të shikoj diçka që është larg ose e padallueshme. Në këtë rast sytë mbyllen përgjysmë për të zmadhuar gjerësinë e fushëpamjes në thellësi e kësisoj sytë sikur bëhen më të mprehtë, më depërtues. **Alzare gli occhi su...** = **mettere gli occhi su** = **levare gli occhi su** – “i ngre sytë lart”; shoh (vras) lart (rëndë). Synoj një marrëdhënie sidomos martesore me një person të një klase shoqërore ose ekonomike më të lartë. Synoj të arrij një pozitë etj. **Anche l’occhio vuole la sua parte** – “edhe syri kërkon pjesën e vet”; edhe pamja (paraqitja) luan rolin e vet; edhe pamja e jashtme ka rëndësinë e vet; vesha kopileshta. Thuhet për diçka, që nuk duam të jetë vetëm e dobishme, por të na kënaqë edhe syrin, domethënë, të na kënaqë nga ana estetike, të jetë e bukur brenda ligjeve të llojit të vet; brendia është e rëndësishme, por edhe pamja e jashtme duhet. **Aprire gli occhi** – “i hap sytë”; merr vesh të vërtetën. Kupton të vërtetën e papëlqyeshme, që as ishte imagjinuar më parë dhe, në veçanti, ku ishte gabuar në vlerësimin e diçkaje. Përgjithësisht u referohet njerëzve të shtënë ose mashtrues. Përdoret për të treguar situata që shfaqen më të rrezikshme, sesa ç’mendohej; i bëj sytë katër; jam vigjilent. **Aprire gli occhi a qualcosa** – “i hap dritë diçkaje”; bëhem i ndërgjegjshëm për diçka; hedh dritë mbi diçka; zbuloj (zbardh) diçka; e vlerësoj (në aspekte, për të cilat as që ishte menduar kurrë). **Aprire gli occhi a quacuno** – “i hap sytë dikujt”; i tregon dikujt të vërtetën (rrugëzgjidhjen ose si mund të shmangët rreziku) I zbulon dikujt një realitet, që ai nuk e kishte vënë re më parë, zakonisht të papëlqyeshëm. Në veçanti, e bën një njeri të kuptojë mundësinë e një mashtrimi, e një rrjeti të rrezikshëm, e qëllimeve të vërteta të dikujt etj. **Aprire gli occhi ai ciechi** – “u hap sytë të verbërve”; bind dikë për diçka të pakëndshme. Edhe: e mësoj dikë, i shpjegoj, e sqaroj për diçka të rëndësishme. Në kuptimin e gjerë: zbuloj të vërtetën thelbësore, kthjelloj mendjen dhe shpirtin e dikujt. **Armato fino agli occhi** – “i armatosur deri te sytë”; i armatosur deri në dhëmbë. **Avere ancora negli occhi** – “ende e kam ndër sy”; kam një kujtim të gjallë për diçka. E kujtoj sikur ta kem para sysh diçka ose sikur të kishte mbetur akoma brenda syve. **Avere buon occhio** – “ka sy të mirë”. Di të llogarisë dhe të vlerësojë mirë. Shpesh përdoret për matjet, për gjëra, njerëz apo situata të ndryshme. **Avere davanti agli occhi** = **avere sotto gli occhi** – “e kam para syve”; sheh mendja e jo syri; kërkoj kapelën që e kam në dorë. Mbaj në dorë një send, që po e kërkoj gjithandej; kërkoj zgjidhjen e një problemi (kur atë e kam) ose provën e qartë të diçkaje. U referohet si gjërave konkrete, ashtu edhe atyre abstrakte. **Avere gli occhi fuori dalle orbite** = **avere gli occhi fuori della testa** – “i kam sytë jashtë gropëzave të tyre (kokës)”; i zgurdulloj sytë; i hap sytë; shoh me sytë gapërr (të zgurdulluar, të pangopur). Ka edhe kuptimin: jam shumë i habitur (i frikësuar, i xhindosur etj.); shoh me sy të ngulitur diku (në një pikë) si i çmendur, me lakmi të madhe. Jam i tërbuar, me sy të shtrembëruar, që shprehin zemërim, saqë duket

sikur ata kanë dalë nga gropëzat e tyre. **Avere gli occhi che si chiudono** = **avere le palpebre che si chiudono** - “*i kam sytë gati për t’u mbyllur*”; po më mbyllen sytë (qepallat); po kapis sytë; po më këput gjumi; kam shumë gjumë; vdiqa për gjumë. **Avere gli occhi pesanti** = **sentirsi gli occhi pesanti** = **sentire le plebre pesanti** - “*i kam (i ndjej) sytë (qepallat) të rënduar(a)*”; më rëndohen sytë për gjumë; më këputi gjumi; vdiqa për gjumë. **Avere gli occhi più grandi della pancia** = **avere gli occhi più grandi dello stomaco** - “*i ka sytë më të mëdhenj se barku (stomaku)*”; e ka nepsin më të madh se oreksin; vlerëson (parashikon) me tepri. Thuhet zakonisht për një person, që ka më shumë oreks dhe lë në pjatë një pjesë të mirë të ushqimit të dëshiruar. **Avere gli occhi foderati di prosciutto** = **avere gli occhi foderati di panno** = **avere le fette di prosciutto sugli occhi** = **avere le fette di salame sugli occhi** - “*i kam sytë të mbështjellë me proshutë (feta proshute, sallami)*”; i kam sytë me lesh; më kanë zënë sytë lesh; më janë verbuar sytë; nuk shoh as gjërat më të dukshme; nuk jam fare largpamës; jam dritëshkurtër (miop); nuk dalloj të mirën nga e keqja. **Avere l’occhio a qualcosa** - “*e kam syrin te diçka*”; atje e kam syrin; atje më rri syri; s’e nxjerr nga syri. I kushtoj vëmendje diçkaje, e mbaj diçka nën kontroll; kujdesem për diçka. Edhe: pres çastin e përshtatshëm për korrijen e suksesit, për një favorizim etj. Kam njohuri dhe përvojë falë zakonit, ngaqë e kam parë diçka shumë herë; njoh shumë lehtë, menjëherë etj.; s’më gënjen syri. Përdoret për të treguar edhe një veçori të mirë psikologjike për të kuptuar njerëzit, për t’i vlerësuar dhe trajtuar si duhet. **Avere l’occhio a tutto** = **tenere un occhio a tutto** = **avere occhi per tutto** - “*i kam (i mbaj) sytë për gjithçka*”; s’më shpëton gjë (pa parë); arrij të ndjek gjithçka; s’i shpëton dot gjë syrit tim. Nuk humbas nga shikimi asnjë hollësi; jam i zënë me punë të ndryshme njëkohësisht. **Avere l’occhio clinico** - “*ka sy klinik (mjeku)*”; ka sy të mprehtë; ka aftësinë të formulojë menjëherë gjykime; kupton menjëherë. **Avere les bende agli occhi** - “*kam fasha në sy*”; i kam sytë të zënë; më janë zënë sytë; jam verbuar nga pasioni etj.; më erren sytë; më kanë plasur sytë. **Avere solo gli occhi per piangere** = **non aver più neanche gli occhi per piangere** - “*ka vetë sytë për të qarë*”; ka mbetur trokë fare; ka mbetur pa miell në magje; i ka zënë shosha (hambari) merimanga; i ushtojnë sheket (kadet, hambarët). Është fare trokë, saqë ka vetëm sytë, me të cilët qan për gjendjen e tij. **Avere sott’occhio** - “*e kam para syve*”; e mbaj nën kontroll; s’e nxjerr nga syri; nuk e humb nga shikimi; e këqyr mirë. Në kuptimin e figurshëm: e kam diçka të pranishme në mendje, e kujtoj sikur ta kisha tani para syve. **Avere un occhio alla padella e uno al gatto** - “*e kam një sy nga tigani dhe tjetrin nga maçoku*”; kujdesem njëkohësisht për dy punë (persona ose situata); i bëj sytë katër; i mbaj sytë hapur; ruhem; bëj kujdes; vigjilenca s’është kurrë e tepërt. E kam mendjen njëkohësisht në dy probleme, që kërkojnë kujdes të barabartë, sepse mund të ndodhin gjëra të papëlqyeshme. **Avere un occhio di riguardo** = **usare un occhio di riguardo** = **con un occhio di riguardo** = **tenerci su un occhio di riguardo** - “*kam një sy të kujdesshëm*”; i lëshoj vendin; e kam (e mbaj) mbi kokë; i zbardh faqen; bëj diçka për hir të dikujt. Ndihej dikë për njohjen e meritave të tij, për respektin ndaj tij; trajtoj dikë me respekt. Edhe: vë në dukje rëndësinë e një episodi, të një koncepti, të një lëvizjeje artistike etj., krahasuar me të ngjashmet, sidomos bëhet fjalë për mjediset e një ceremonie publike. **Avere fino agli occhi** = **avere sino agli occhi** = **avere fino sopra gli occhi** - “*e kam deri në sy (deri sipër syrit)*”; më ka ardhur në majë të hundës; më ka ardhur deri këtu; më mërzi për vdekje; ma ka sjellë shpirtin në fyt (ndër dhëmbë). Jam shumë i lodhur dhe i mërziur, i shqetësuar nga një person ose një situatë, sikur të bëhej fjalë për diçka, që është zhytur deri në lartësinë e syve. **Balzare all’occhio** = **saltare all’occhio** - “*del (kërcen) nga sytë*”; bie në sy; bën mu; është shumë i qartë; dallohet nga kthjellësia e vet. Përdoret kryesisht për gjëra që duhet të kishin mbetur të fshehura, për mangësitë, gabimet, cenet, dallimet, epërsitë etj. **Bocca chiusa e occhio aperto** - “*gojëkyçur dhe syhapur*”. **Buttare la polvere agli occhi** - “*i hedh hi*

Sinonimia frazeologjike në fjalorët dygjuhësh italisht shqip...

(*pluhur*) syve”; e hedh kodër më kodër; e rruaj pa lagur; i vë syze (gjyzlykë); e nis me shoshë për ujë. **Cavare gli occhi a qualcuno** – “i nxjerr sytë dikujt”; shamatohem fort me dikë; zihem (kapem) për fyti (për gryke); i bëj potere me egërsi (me mllef, me mëri) me dikë; bëj namin; të kem ta zhdëp (ta ngordh, ta mbys) dikë. Përdoret, pra, edhe për të shprehur një dëshirë të dhunshme hakmarrjeje. **Cavarsi gli occhi** – “nxjerr sytë”; më dalin sytë (nga drita e dobët etj.). **Chiudere gli occhi** – “mbyll sytë”; vdes; i mbyll sytë (të vdekurit). Ka edhe kuptimin nuk dëshiroj të shoh një realitet, një të vërtetë të papëlqyeshëm; nuk vë re një të metë, shtirem sikur nuk e kam parë (sepse në këtë çast i kam mbajtur sytë mbyllur). **Chiudere un occhio** – “mbyll një sy”; jam i butë, i durueshëm; bëj sikur nuk vë re; e bëj një sy qorr e një vesh të shurdhër. Nganjëherë bëhem bashkëfajtor me atë që gabon, si ai që shkel syrin e jep të kuptojë se pajtohet me një veprim të caktuar. **Chiudere un occhio su qualcosa** = **chiudere gli occhi su qualcosa** – “mbyll një sy për diçka”; shoh nëpërmjet gishtave të dorës; qorroj njërin sy. **Colpo d’occhio** – “goditje syri”; shikim (vështrim) i shpejtë; një sy. Më gjerë: vështrim i përgjithshëm. **Comme il fumo negli occhi** – “si tymi në sy”; si baltë e ngritur; i mërziqshëm; si kripa në sy. **Come un pugno in un occhio** – “si një grusht në një sy”; si halë (plagë, ferrë) në sy. **Con gli occhi in fuori** – “me sy të dalur përjashta”; me sy të zgurdulluar. **Con la coda dell’occhio** = **vedere con la coda dell’occhio** – “(shoh) me bishtin e syrit”; (shoh) shtrembër; e shikoj dikë vëngër. (Shih: *Guardare con la coda dell’occhio*). Thuhet për një shikim anësor, pa e lëvizur kokën, por që bëhet me paramendim dhe në mënyrë pak tinëzare për të mos rënë në sy që po e vëzhgon dikush. **Con occhio distratto** – “me sy të përhumbur”; si i hutuar; pa e pasur mendjen. **Con tanto d’occhi** = **guardare con tanto d’occhi** = **fare tanto d’occhi** – “me tërë sy”; me sytë dollap; me sy të kërcyer; i hap sytë filxhan, si dac; i hap sytë dollap; i zgurdulloj sytë; shikoj me habi të madhe; befasohem. **Costare un occhio** = **costare un occhio della testa** – “kushton një sy”; më kushton shumë shtrenjtë; kushton qimet e kokës; kushton pikë e gjak; më kushton sa një sy i ballit. Përdoret me foljet: *spendere* (harxhoj); *valere* (vlej); *pagare* (paguaj), me të cilat tregon një shumë tepër të madhe parash. Përdoret edhe me kuptimin: vë bast për një pasuri të madhe dhe një sy. Zakonisht përdoret nga një person, i cili është shumë i sigurt për atë që deklaron. **Covare con gli occhi** – “ngroh me sy”; përpj me sy; shikoj dikë me dashuri (pandërprerë, sikur dua ta ruaj, ta shoh si është, të sigurohem). **Crescere a vista d’occhio** – “(të) rritet ndër sy (para syve)”. **Dare all’occhio** = **dare nell’occhio** – “bie në sy”; është tërheqës. Është joshës për veshjen e veçantë, për sjelljen ose për disa karakteristika, që spikasin në një mjedis të caktuar. **Dare d’occhio a qualcuno** – “ia bëj me sy dikujt”; i shkel syrin dikujt. **Dare un occhio a...** – “i jap një sy...”; i hedh një sy; kontrolloj; kujdesem për diçka ose për dikë; marr nën kujdestari një person për një periudhë të kufizuar në mungesë të të interesuarve të drejtpërdrejtë ose të atyre që përgjigjen për të. **Dare un occhio per...** = **dare un occhio pur di...** – “i jap një sy për... (thjesht për...)”; jam i gatshëm të sakrifikoj për... Paguaj që të jem në një vend të caktuar për të parë, për të mësuar, për të bërë ose për të njohur diçka. **Dormire ad occhi aperti** – “fle me sy hapur”. **Dove hai gli occhi?** – “ku i ke sytë?”; a i ke sytë në ballë? a sheh nga sytë? **Essere l’occhio destro di qualcuno** – “është syri i djathtë i dikujt”; është i parapëlqyeri (i përkëdheluri, kanakari) i dikujt; e ruan dikë si sytë e ballit. **Eserci dentro fino agli occhi** – “jam brenda deri te sytë”; jam zhytur deri në fyti; jam ngatërruar keq në një çështje (sikur të isha zhytur brenda saj deri në lartësinë e syve). U referohet punëve të ndërlikuara e të papëlqyera ose më pak të ndershme, si sherret, borxhet, krimet, skandalet etj. **Essere tutt’occhi** – “jam tërë sy”; i bëj sytë katër; shikoj (ndjek) diçka i përqendruar. Në vend të saj mund të përdoret edhe: **Essere tutt’occhi e tutt’orecchi** – “jam tërë sy e veshë”; i bëj sytë katër e veshët bigë. **Fare a occhio e croce** – “(e) mat me sy kryq e tërthor”; mat (vlerësoj) me të parë (afërsisht, nga e keqja, sidokudo); mat me sy, me përafërsi. (Në vend

të kësaj shprehje frazeologjike mund të përdoren edhe: **Fare una cosa a lume di naso** – “e bëj diçka me intuitë”. **Fare a braccio** – “mat me krah, me pash, përafërsisht”. **Fare gli occhi alle pulci** – “i bëj sytë si pleshta”; e ndaj (e çaj) qimen (më) katërsh (dysh). Jam shumë i shkathët në çdolloj veprimtarie e pune të imët, në punët që kërkojnë saktësi dhe durim. Më gjerë: jam shumë i rreptë. **Fare l’occhio del porco** – “e bëj syrin si të derrit”; shikoj vjedhurazi; shikoj me bisht të syrit. Shëmbëllesa është marrë nga derrat, që i kanë sytë të vegjël dhe shumë të lëvizshëm e që janë bërë shkas për krijimin e shprehjeve të tipit: **Sguardo porcino** – “shikim derri”; vështrim shtrembër (tërthor). **Occhi porcini** – “sy derri”; sy si të derrit; sy të veckël. **Fare gli occhi dolci** – “i bëj sytë të ëmbël”, perëndoj (fal) sytë (për dikë që dua); shpreh një dashuri të përgjëruar. Në kuptimin e gjerë: përpikem të ngashënej, të mikloj, të demonstroj qëllimin sentimental ose seksual, në përpjekje për të fituar simpatinë dhe vëmendjen e së dëshiruarës. **Strizzare l’occhio** – “shkel (luaj) syrin”; bëj me sy; bëj shenjë me sy. Duke mbyllur shpejt një sy (që në italishte quhet *occhiolino* – sy i vogël), jap sinjalin se e mora vesh sesi është puna. **Tenere gli occhi addosso** – “ia mbaj (qep) sytë nga pas”; e ndjek hap pas hapi; i bëhem ferrë. E ndjek dikë me kujdes, vrojtoj sjelljen e tij pa iu ndarë, duke u përpjekur ta zë në gabim. **Tenere gli occhi aperti** = *tenere gli occhi ben aperti* – “i mbaj sytë hapur”; jam syçelët, vigjilent; nuk lë të më kalojë (të më shpëtojë) asgjë; i bëj sytë katër. Jam në gatishmëri dhe vështroj me kujdes çka ndodh rretheqark. **Tenere gli occhi bassi** – “i mbaj sytë ulur”; i mbaj sytë përdhe; shikoj në tokë (nga turpi, frika ose në shenjë bindjeje dhe nënshtrimi). **Un occhio della testa** – “një sy i kokës”; ta jep në lule të ballit. Përdoret me foljet: *spendere* (harxhoj, shpenzoj), *valere* (vlen), *pagare* (pagoj) etj., dhe tregon një shumë të madhe parash. **Uscire dagli occhi** – “po më dalin nga sytë”; jam nginjur (ngopur) deri në fyt; jam bërë derr. U referohet sendeve ose njerëzve që janë mërzitur nga sasia e bollshme ose prania e diçkaje dhe mërzia e brendshme është rritur aq shumë, sa nuk mund të matet e tani ka filluar e grafullon edhe nga sytë. **Vedono più quattrnocchi che due** – “më shumë shohin katër sy sesa dy”. Në kuptimin e figurshëm: një mendje është mirë, por dy janë akoma më mirë; më mirë dy mendje sesa një. **Veder qualcosa con occhi diversi** – “e shoh diçka me sy tjetër”; e shoh diçka nën një dritë tjetër; e trajtoj një problem ndryshe.⁸

Siç shihet frazeologjia sinonimike shfaqet jo te frazeologjia e italishtes, por në barasvlerësit e shqipes. Në të gjitha njësitë kemi frazeologji sinonimike. Madje si njësi frazeologjike mund të kemi edhe në njësinë frazeologjike titull në italisht, për të cilën autorët e zgjidhin duke e sqaruar *përdorimin sinonimik* me ndërtimin “mund të përdoren edhe”. P.sh. **Guardarsi gli occhi** = **perdersi gli occhi** – “dëmtoj sytë”. Rrezikoj të dobësoj ose të dëmtoj shikimin nga një punë e imët e që kërkon durim. Mund të përdoren edhe: **Cavarsi gli occhi** – “nxjerr sytë”. **Consumarsi gli occhi** – “lodh sytë”. **Perdere gli occhi** – “humbas sytë”. **Lasciarsi gli occhi** – “lë sytë”.

Si përfundim, sinonimia me njësi frazeologjike në një fjalor të përgjithshëm dygjuhësh është tepër – tepër e rrallë, për të mos thënë mungon krejt. Kurse në një fjalor dygjuhësh frazeologjik sinonimia zë një vend qendror për gjuhën e dytë, kurse në gjuhën e parë ajo thuhet mungon sepse autorët e japin njësinë si fjalë titull. Në këtë gjuhë mund të gjendet sinonimia vetëm në qoftë se kërkohet nga pozitat e studiuesit dhe organizimin sinonimik e bën vetë studiuesi.

⁸ Naim Balla, Eshref Ymeraj, Irena Ndoci (Lama), *Fjalori i madh frazeologjike italisht – shqip*, Tiranë, 2007.